

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aarapi@infosoftoffice.al

E-mail

Administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/02/14

Data (viti/muaji/dita)

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-58476-02-08-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit Tirane

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

1166000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje Kancelari

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/02/20

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/02/20

Numri i njoftimit

Kodi CPV

58476

30190000-7

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligjin për Prokurimin Publik, nr. 162 dt. 23.12.2020, në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit Tirane, ka publikuar në faqen e APP-së në datë 09.02.2023, ora 0900, tenderin me objekt “Blerje kancelari”, i cili parashikohet të zhvillohet me datë 20.02.2023, ora 0900

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Duke qenë se disa prej këtyre kërkesave i gjykojmë në shkelje të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik, po paraqesim këtë ankesë.

Ne shtojcën 5 “Specifikimet teknike” në DST, AK ka kërkuar:

14 Leter format A4 80g/m2 Leter fotokopje A4 80g/m.- Përmasa 29.7x210, A4.- Lëmueshmëria: 80-130 ml/min.- Amballazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma.- Përdorimi për fotokopje dhe printim.- Lagështia: 3.5-4.5%.- Trashësia: 101-107 ?m.- Dukshmëria:>94%.- Shkëlqimi: 101-115%.- CIE bardhësia: 157-163.- Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin.- Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit.- Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit.- Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët.- Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë sipas ISO-s 9706 ,80 gr/m2 - Të mos jetë e ricikluar. - Me risma 500 flete secila. Ngjyra e bardhe. Vendi I origjines duhet te jete Europian.

Te kete kualitet ne printim dhe te konsumoje sa me pak boje.

Me barkod te stampuar original te prodhuesit.

37 Letër format A3 Letër fotokopje me ngjyrë A3 80gr/m3. Pako me 500 fije.Te jete cilesi e pare.Europian.

Te kete kualitet ne printim dhe te konsumoje sa me pak boje.

Me barkod te stampuar original te prodhuesit.

Per artikujt me numer rendor 14 dhe 37, AK ka kërkuar qe vendi i origjines te jete i vendeve te Komunitetit Europian, duke percaktuar keshtu origjinen e mallit (vendin e prodhimit). Kjo kerkese bie ne kundërshtim me ligjin dhe Rregulloren e Prokurimit Publik, prandaj kerkojme te hiqet percaktimi nga ana juaj qe vendi i origjines te jete i komunitetit Europian.

Neni 36 LPP162/2020 , pika 4, percakton :

Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Gjithashtu sjellim ne vemendje se kete kerkese, AK e ka modifikuar dhe vitin e kaluar, pasi kjo kerkese eshte ne tejkalim te kompetencave te AK si dhe ne kundërshtim me ligjin.

Sa me lart, kerkojme heqjen e ketij kriteri.

Me tej, po ne specififikimet teknike te vendosura nga ana juaj kerkojme qe letra te jete "Me barkod te stampuar original te prodhuesit". Kerkesa qe letra te jete me barkod eshte e egzagjeruar dhe e panevojshme pasi . permbushja e ketij kriteri nuk varet nga vullneti i Operatorit Ekonomik. Ka prodhues qe nuk e vendosin barkodin ne paketimin e letres. Ne keto kushte, kerkojme qe te hiqet fjalia "Me barkod te stampuar original te prodhuesit".

Sjellim ne vemendje qendrimin qe ka mbajtur KPP me Vendimin Nr. 255 /2022, sa i perket kesaj ceshtje, pikerisht per proceduren me te njejtin objekt, zhvilluar nga ana juaj vitin e kaluar : "Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 "Komisioni European vs. Mbretëria e Hollandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsytuar se: "Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specififikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese." III.1.5. KPP gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh" të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikimet teknike në lidhje me produktet e kërkuara, por pa përcaktuar kërkesa të cilat krijojnë konfuzion apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. III.1.6 Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se ky i fundit, në trajtimin e ankesës së OE "InfosoftOffice" SHPK, në lidhje me heqjen e kërkesës "Me barkod të stampuar origjinal të prodhuesit" nga specififikimet teknike për art letër A4 dhe A3", nuk ka dhënë asnjë argument bindës që të kundërshtojë këtë pretendim. 12 Autoriteti kontraktor dhe njësi përgjegjëse e hartimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit, në lidhje me art. Letër A4 dhe A3 mund të vendosë parametra të skedës teknike që përshkruajnë tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërës dhe që përshkruajnë e garantojnë cilësinë e kërkuar të letrës. Komisionit të Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specififikimet teknike të artikujve Letër A4 dhe A3 duke hequr specifikimin "Me barkod të stampuar origjinal të prodhuesit". Rrjedhimisht, pretendimi e operatorit ekonomik ankimues "Infosoft Office" SHPK qëndron."

Ne shtojcen 5 "Specifikimet teknike" ne DST, per artikullin Nr.2, Nr.22 dhe Nr.31 , AK ka vendosur kriteret teknike te ekzagjeruara, si me poshte :

- 2 Dosje plastike me ngjitëse
- Formati A4 , plastike me mbyllje me ngjitje.

Keni kerkuar qe dosja plastike ta kete mbylljen me ngjitese. Duke marre ne kosiderate se ka dosje plastike te cilat e kane mbylljen me llastik apo me buton , kerkojme qe te mos e kufizoni kerkesen qe dosja te jete me mbyllje me ngjitje, por edhe ne forma te tjera ekuivalente. Mjafton qe te kryeje funksionin e mbylljes.

22 Set tavoline lekure

Tapet tavoline me xhep te brendshem min 60-max 68 x min 35- max 41. Tapet tavoline me hapje nga lart min 45, max 53x min 33.5, mx 38.5 cm, Mbajtese dokumentash min 30, max 35x min 23, max 26 cm, Mbajtese stilolapsash min 13.5, max 16x min 5, max 6.5 cm, Mbajtese Stick notes min 10, max 11x min 10, max 11 cm. Mbajtese statike e stilolapsit +ore min 20, max 22 x min 5, max 6 cm.

Per kete artikull keni kerkuar Tapet tavoline me xhep te brendshem min 60-max 68 x min 35- max 41. Tapet tavoline me hapje nga lart min 45, max 53x min 33.5, mx 38.5 cm . Setet e tavolinave kane nje tapet (me hapje ose jo) dhe jo dy tapete sic jeni shprehur ju. Nuk e kuptojme se per cfare nevojiten dy tapete?! Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi duke kerkuar vetem nje tapet. Tek ky artikull kerkoni gjithashtu dy mbajtjese stilolapsash Mbajtese stilolapsash min 13.5, max 16x min 5, max 6.5 cm , Mbajtese statike e stilolapsit +ore min 20, max 22 x min 5, max 6 cm , ku njera kerkohet te jete me ore dhe tjetra pa ore. Kerkesa per dy mbajtese stilolapsash eshte pa sens, pasi setet e tavolinave kane nje mbajtjese stilolapsash dhe jo dy. Per me teper, qe njera mbajtese te jete me ore, eshte nje kerkesa e egzagjuar dhe qe kufizon konkurrencen. Per kete arsye, kerkojme qe te hiqet kerkesa qe seti i tavolines te kete Mbajtese statike e stilolapsit +ore min 20, max 22 x min 5, max 6 cm .

31 Kalendar tavoline lekure

Përmasat 15x30cm-min

Përmasat 20 x 40 cm max

Kerkesa qe kalendari te jete material lekure eshte e egzagjuar dhe nuk ndikon ne funksionaliteitn e produktit. Per kete arsye kerkojme qe ky specifikim te hiqet.

Per tre artikujt sa me lart, per te cilat kerkojme modifikim ju sjellim ne vemendje qendrimin qe mban KPP per specifikimet teknike te ekzagjuara, percaktuar ne Vendimin Nr. 124/2022: "III2.8 KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa "dh" se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Referuar objektit dhe volumit të kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, thekson se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të krijojë bindjen se operatorët ekonomikë kanë aftësi të ofrojnë produktet objekt-prokurimi, të nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës, por gjithmonë duke përcaktuar kritere në përputhje me objektin e kontratës, në përpjesëtim me volumin e saj, si dhe jo kufizuese apo diskriminuese. Komisioni gjykon, se është e nevojshme që operatorët ekonomikë të ofrojnë produktet objekt-prokurimi por jo domosdoshmërisht në mënyrë kufizuese, pasi në fushën e veprimtarisë objekt-prokurimi, ekzistojnë edhe artikuj të tjerë ekuivalent, të cilët kanë funksionalitet të njëjtë. Gjithashtu, Komisioni gjykon, se edhe kërkesa për disponimin e artikujve me këto specifikime është e ekzagjuar. Autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike

kufizuese e përjashtuese, me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, ndaj çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti tij/saj.”. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të zbatohet me përpikëri dispozitetin e mesiperme të LPP-se në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit duke shtuar termin ekuivalent për zerat e sipërpermendur.”

Në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” në DST, për artikullin Nr.4, AK ka kërkuar:

- 4 Staples 24/6 + 23/13, 100 kuti 24/6, 100 kuti 23/13
- Makinë kapse aktesh 24/6+23/13. Te jete metalike me trup metalik gri e erret dhe pjesë plastike të zeza. Te jete shumë cilesore

Për këtë artikull nuk përputhet emertimi me specifikimet teknike. Meqenëse kërkoni 200 kuti, mendojmë që i referoheni kutive me tela, megjithatë ju lutemi rregulloni specifikimet. Kërkojmë gjithashtu që telat 24/6 dhe 23/13 të ndahen në zera të vecante, pasi janë artikuj të ndryshëm (mëqë ndryshon permasa) dhe kanë kosto të ndryshme.

Në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” në DST, për artikullin Nr.5, AK ka kërkuar:

- 5 Kapëse dokumentash
- Kapëse dokumentacioni. Sqarim: Kapëse dokumentash min 3cm-5 cm max (materiali metalik)

Nuk jemi të qartë se çfarë kërkoni për këtë artikull. Ju lutemi vendosni me shumë specifikime. Psh. kapëse aktesh, kapëse me veshe etj..

Në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” në DST, për artikujt Nr.17 dhe 21, AK ka kërkuar:

- 7 Stik ngjitës deri në 36gr Stik deri në 36 gram
- 9 Libër Magazine deri në 200 flete Liber Magazine I thjeshtë
- 17 Kapëse aktesh Kapëse aktesh metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm me permasa deri në 41mm, paketimi deri në 12.
- 21 Makinë llogaritëse profesionale Me llogaritje të dyfishtë energjie për zyra. Deri 16 digit.
- 35 Vinovilderi në 1 kg Vinovil cilesia e 1

Fjala “deri në” krijon konfuzion. Me këtë logjikë i bie që AK të pranojë produkte me paketim apo permasa me të vogla? Psh nëse në ofertojmë një makinë llogaritëse me 12 shifra, a do të quhet e plotësuar kërkesa e AK?

Sa më sipër kërkojmë saktësimin e specifikimeve teknike, për të shmangur konfliktet që mund të lindin gjatë levrimit të mallit.

Në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” në DST, për artikullin Nr.33, AK ka kërkuar:

- 33 Bllokë axhende.
- Imitacion-lëkure
- Sasiaefleteve-168
- Axhenda e vitit 2023, Permasat 23 x30 cm min- 25 -32 max

Permasat qe keni vendosur per kete artikull jane jashte standartit te prodhimit te axhendave. Permasa e sakte per modelin e axhendes qe ju kerconi eshte 21cm x 29.7cm, pra eshte 2cm me e ngushte se minimumi qe ju keni vendosur. Meqenese kjo diference nuk ndikon ne funksionin e produktit, kerkojme qe minimumi i permasave te behet 21cm x 29.7cm. Bashkelidhur po ju dergojme edhe nje faqe katalogu prodhuesi, ku jane te pasqyruara permasat e axhendave.

Ne shtojcen 5 “Specifikimet teknike” ne DST, per artikullin Nr.41, AK ka kerkuar:

41 Liber Protokolli Liber Protokolli I thjeshte me minimum nga 100 flete deri ne 500 flete.

Per artikullin Nr.41 AK vendos nje diapazon konsiderueshem te madh 100 deri ne 500 flete. Gjykojme te arsyeshme te percaktohet skatesisht numri i faqeve per kete artikull, pasi eshte nje nga elementet me te rendesishem te tij. Nje liber me 500 flete eshte thujse 5-fishi i kosos se librit me 100 flete.

Ne shtojcen 5 “Specifikimet teknike” ne DST, per artikullin Nr.44, AK ka kerkuar:

44 USB 32 GB.

50 Copë

USB 64 GB

50 Copë Te sigurojne ruajtje te sigurt dhe afatgjate te te dhenave,te jete cilesore.

32 Blinder clipps me madhësi të ndryshme 32,18

Permasat nga 32 mm,deri 18 mm,

600 copë deri 32 mm

400 copë deri 18 mm

Sa me siper, AK ka kerkuar dy artikuj te ndryshmem nen nje ze. Artikujt jane te ndryshem, me specifikime teknike te ndryshme dhe rrjedhimisht me cmime te ndryshme. Dy artikuj te ndryshem nuk mund te ofertohen me te njejtin cmim. Kerkojme qe keto dy artikuj te ndahen ne zera te vecanta, ne menyre qe te mos kete konfuzion ne ofertim.

Po paraqesim këtë ankesë mbështetur në LPP, Udhëzimet e APP, duke kërkuar modifikim të disa kërkesave të tenderit.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

nuk ka

7. Lista e informacionit konfidencial:

nuk ka

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

aarapi@infosoftoffice.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Frederik Prodani